REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br: 143/17
Date/Datum: 12.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 143/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej z.Goran Milenkovic – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: **"Rosa Security"shpk -** Prizren, me nr. **143/17**, kundër AK – **Komuna Mamush**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Mamushës",** me nr. prok: **626/17/001/236**, në seancën e dt. **07.06.2017**, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** , ankesat e OE, **"Rosa Security"shpk - Prizren**, me nr. **143/17**,, e parashtruar kundër AK – Komuna Mamushë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Mamushës",** me nr. prok: **626/17/001/236,,** si e bazuar.

II. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues / **Komuna Mamushe,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Mamushës",** me nr. prok: **626/17/001/236**, si i pa bazuar.

III. **Obligohet,** autoriteti kontraktues / **Komuna Mamushe**, që proceduren e prokurimit me titull: "**Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Mamushës",** me nr. prok: **626/17/001/236,** ta kthej në **Ri-vleresim.**

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

VI. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues **"Rosa Security"shpk – Prizren,** janë te bazuara, konform nenit 118 të LPP-së i bëhet kthimmi i sigurimit të ankeses, megjithatë i njejtit OE, obligohen që në periudhën kohore prejë më së largu gjashtëdhjetë (60) diteve, të parashtrojnë kërkesë për tërheqje të mjeteve, në të kundërtën mjetet do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues – Komuna Mamush, më datën: 14.04.2017, ka publikuar njoftim për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Mamushës",** me nr. prok: **626/17/001/236**.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjëshëm me çmim më të ulët.

Kundër njoftimit për dhënje të kontratës, operatori ekonomik, **"Rosa Security"shpk – Prizren,** në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankes në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesave, në bazë të nenit 113.1, të LPP-ës nr.04/L-042, më datën. **24.05.2017**, ka autorizuar ekspertët e OSHP-së, për të shqyrtuar zbatimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Ekspertëti e OSHP-së, më datën. **31.05.2017**, i dorëzojn Panelit Shqyrtues raportin e ekspertizës , ku në raportin e tyre kane shqyrtuar – trajtuar pretendimet ankimore te perfshira ne ankese, njëkohësisht kanë propozuar që lënda të kthehet në ri-vleresim ndërsa ankesa të aprovohet si e bazuar.

Autoriteti kontraktues / Komuna Mamushe, përmes parashtresës me shkrim të dt. **02.06.2017**, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. **31.05.2017**,

Operatori ekonomik **"Rosa Security"shpk** – Prizren, poashtu përmes parashtresës me shkrim të datës **31.05.2017**, njofton panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e dates **31.05.2017**.

Gjatë seances së shqyrtimit kryesorë të datës. **07.05.2017**, e cila u mbajt pa prezencen e paleve konform nenit **26**, paragrafi **1**, të rregullorës së punës së OSHP-së, ku ishin prezent kryetari i panelit shqyrtues dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndes duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit, rrjedhimisht paneli shqyrues konstatoi se pretendimet ankimroe të parashtruesit të ankesës janë të qëndrueshme për faktin se operatori ekonomik, i rekomanduar për dhënje të kontratës nuk i përmbush në tërësi kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional, gjegjësisht sipas shkresave të lëndës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka realizuar ndonje projekt brenda periudhës së kërkuar dhe me vlerën e kërkuar ne piken III.2.4, te njoftimit për kontrat, rrjedhimishte vleresimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me dispoziatar e nenit 59, paragrafi 4, të LPP-së në fuqi.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE :
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës themelore-Departamentit për çështje
Administrative për kompensim dëmi në afat prej
30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – Ankuesve
1x1 ekzemplar - Autoriteti Kontraktues
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenkoviç